REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRISË

## DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8098 Tirane, date 15/12/2015

**Drejtuar:** **ZOTIT DRITAN KUÇI**
**SHOQERIA "ELITE - MINE" SHPK**
**RRUGA "ISMAIL QEMALI", KULLA "SAMOS TOWER", APARTAMENTI NR.46, KATI I NËNTË,**
**TIRANE**

**Për njoftim:** **Z. VIKTOR DODA, DREJTOR I PERGJITHSHEM**
**SHERBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR**
**RRUGA E KAVAJES NR.153**
**TIRANE**

**Lënda:** Njoftim mbi fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr. 1695 date 01.04.2014

**I nderuar zoti Kuçi,**

Shoqëria "Elite – Mine" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te kërkim - zbulimit nr. 1695 date 01.04.2014, për mineral rëra bituminoze, ne Selenice, Qarku Vlore, Qarku Vlore.

Nga struktura përgjegjëse Shërbimi Gjeologjik Shqiptar me shkresën nr.1545 date 02.11.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr. 7189 date 03.11.2015 është propozuar revokimi i lejes nr. 1695 date 01.04.2014, sepse nuk është filluar veprimtaria e kërkim zbulimit brenda 120 dite kalendarike nga date e hyrjes ne fuqi te lejes ne përputhje me pikën 1, te nenit 13 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Propozimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për revokim e lejes nr. 1695 date 01.04.2014, është i mbështetur ne ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi ju keni shkelur germën "b" te pikës 1 te nenit 47 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, qe është shkelje ligjore për te cilën një leje minerare revokohet.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, **ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit te lejes nr. 1695 date 01.04.2014, për mineral rëra bituminoze, ne Selenice, te Qarkut Vlore**.

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do merret vendimi për revokimin e lejes minerare nr. 1695 date 01.04.2014.

Ne zbatim te pikës nr.7 te nenit 13 dhe nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e lejes se kërkim - zbulimit ne te cilën keni pasur leje minerare.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

**MINISTRI**

**DAMIAN GJIKNURI**